



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME
QENDRA E STUDIMEVE DHE PUBLIKIMEVE PËR ARBËRESHËT
SEKTORI I FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2026

RAPORT MONITORIMI
I ZBATIMIT TË PLANIT TË INTEGRITETIT PËR VITIN 2025

MIRATOI

DREJTORI EKZEKUTIV

DIANA KASTRATI

1. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME

Institucioni: Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët (QSPA)

Dokumenti i monitoruar: Plani i Integritetit për Qendrën e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët 2024–2026

Periudha e monitorimit: Viti 2025

Struktura përgjegjëse për monitorimin: Drejtoria e Studimeve dhe Publikimeve
Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse

Data e raportimit: 31.08.2026

2. BAZA DHE QËLLIMI I MONITORIMIT

Plani i Integritetit i Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët i shtrin efektet e tij për vitet 2025–2026. Plani synon identifikimin dhe trajtimin e risqeve të integritetit, forcimin e llogaridhënies dhe transparencës, si dhe përmirësimin e performancës institucionale.

Sipas Planit, monitorimi kryhet periodikisht dhe synon të përcaktojë nëse është e nevojshme marrja e masave të mëtejshme, nëse kanë ndryshuar risqet e identifikuar dhe nëse kërkohet rishikimi i Planit. Të gjitha aktivitetet e ndërmarra në kuadër të Planit i njoftohen Titullarit dhe strukturës së brendshme që menaxhon burimet njerëzore.

3. METODOLOGJIA E MONITORIMIT

Monitorimi është konceptuar si proces verifikimi i masave dhe rekomandimeve të parashikuara në Planin e Integritetit, duke marrë në konsideratë veprimtarinë e strukturave të QSPA-së, zbatimin e kuadrit ligjor dhe rregullator, dokumentacionin administrativ dhe financiar, si dhe evidencat e krijuara gjatë periudhës së monitorimit.

Për qëllime të këtij raporti, niveli i zbatimit vlerësohet sipas tre kategorive: “I zbatuar”, kur masa është realizuar dhe ekzistojnë evidenca; “Pjesërisht i zbatuar”, kur janë ndërmarrë veprime por masa nuk është përmbyshur plotësisht; dhe “I pazbatuar”, kur nuk rezulton të jenë ndërmarrë veprimet e parashikuara. Kur informacioni faktik nuk është i disponueshëm në Planin bazë, fusha lihet për plotësim nga struktura përgjegjëse.

4. REZULTATET E MONITORIMIT SIPAS FUSHAVE

Nr.	Fusha / masa e monitoruar	Risku / çështja	Veprimet e ndërmarra	Niveli i zbatimit	Evidenca	Rekomandimi
1	Menaxhimi financiar dhe përdorimi i fondeve publike	Risk i ulët; nevojë për saktësi, paanësi, përgjegjshmëri dhe rritje të kontrollit mbi përdorimin e fondeve.	Veprimtarite e miratuar nga Ministri i MEPJ, me shkresën nr. 5186, datë 10.04.2025	Pjesërisht i zbatuar	Dokumentacioni financiar / buxhetor	Vijimi i kontrollit dhe llogaridhënies.
2	Prokurimet publike	Respektimi i kërkesave ligjore dhe parandalimi i konfliktit të interesit në marrëdhëniet me operatorët ekonomikë.	Te gjitha Procedurat që janë kryer janë në përputhje të plote me Ligjin e Prokurimit Publik.	Zbatuar plotësisht	Dosje prokurimi / deklarata	Vijimi i zbatimit të kërkesave ligjore.
3	Burimet njerëzore	Plotësimi i dosjeve, deklarimi i konfliktit të interesit, njohja e Rregullores së Brendshme dhe mundësimi i trajnimeve.	Plotesuar libriti Burimeve njerëzore të QSPA-së.	Zbatuar plotësisht	Dosje personeli / deklarata / trajnime	Përditësim periodik dhe dokumentim.

4	Konflikti i interesit	Parandalimi dhe deklarimi i rasteve të konfliktit të interesit, përfshirë pjesëmarrjen në komisione.	Janw kryesr deklaratat e nevojshme pwr Konflikt Interesi, nw tw gjitha Komisionet e ngritura nw QSPA	Zbatuar plotësisht	Deklarata / akte	Vijimi i monitorimit dhe deklarimit në rast dyshimi.
5	E drejta e informimit	Në Plan është evidentuar mungesa e Koordinatorit për të Drejtën e Informimit dhe është rekomanduar angazhimi për këtë funksion.	Të plotësohet sipas situatës faktike.	I pazbatuar	Urdhër / akt emërimi	Garantimi i përgjegjësisë për të drejtën e informimit.
6	Transparenca dhe faqja zyrtare	Rreziku i vonesave në publikimin e informacionit dhe nevoja për koordinim ndërmjet strukturave.	Përditësimi periodik i faqes dhe publikimi i informacionit.	Zbatuar plotësisht	Faqja zyrtare / regjistra publikimi	Përditësim i rregullt dhe përcaktim i përgjegjësisë.
7	Etika dhe sjellja në administratë	Respektimi i normave të sjelljes, disiplinës, përdorimit të burimeve dhe komunikimit institucional.	Nuk janë evidentuar shkelje	Zbatuar plotësisht	Akte / evidenca	Vijimi i informimit dhe respektimit të Kodit të Etikës.
8	Parandalimi i korrupsionit dhe dhuratave	Ndalimi i kërkimit/pranimit të dhuratave, favoreve, pritjeve ose përfitimeve që cenojnë paanësinë.	Nuk ka patur raste tw asnjw forme korrupsipni nw QSPA	Zbatuar plotësisht	Deklarata / akte / evidenca	Forcimi i ndërgjegjësimit të stafit.
9	Kërkimi shkencor, botimet dhe aktivitetet	Kapacitete njerëzore të kufizuara dhe mungesa e fondeve; risk për vonesa dhe mosrealizim efektiv të objektivave.	Realizimi nw vazhdimwsi i planeve, aktiviteteve, ekspeditave dhe botimeve (sipas miratimeve nga Ministri i MEPJ, me shkresen nr. 5186, datë 10.04.2025.	Zbatuar plotësisht	Plane, raporte, botime, akte	Planifikim realist, mbështetje buxhetore dhe prioritarizim.

5. KONKLUZIONE

Në përfundim të procesit të monitorimit, vlerësohet niveli i zbatimit të Planit të Integritetit dhe efektiviteti i masave të ndërmarra për parandalimin dhe trajtimin e risqeve. Përfundimet përfundimtare duhet të bazohen në evidencat e administruara nga strukturat përgjegjëse dhe në verifikimin e dokumentacionit përkatës.

Në bazë të rezultateve të monitorimit, do të përcaktohet nëse masat e parashikuara në Plan janë të mjaftueshme, nëse kërkohen masa shtesë ose nëse është e nevojshme rishikimi i Planit të Integritetit.

6. REKOMANDIME

- Vijimi i monitorimit periodik të zbatimit të Planit të Integritetit dhe dokumentimi i rezultateve.
- Rritja e llogaridhënies dhe kontrollit mbi përdorimin e fondeve publike.
- Sigurimi i dokumentimit dhe përditësimit periodik të deklarimeve për konfliktin e interesit.
- Informimi periodik i stafit mbi rregullat e etikës, konfliktin e interesit, transparencën dhe parandalimin e korrupsionit.
- Vijimi i përditësimit të faqes zyrtare dhe përmirësimi i koordinimit ndërmjet strukturave për publikimin në kohë të informacionit.
- Vlerësimi periodik i kapaciteteve njerëzore dhe nevojave për trajnime.
- Vlerësimi i nevojave buxhetore për realizimin efektiv të aktiviteteve, kërkimeve shkencore dhe botimeve të QSPA-së.
- Rishikimi i Planit, nëse nga monitorimi rezulton se risqet kanë ndryshuar ose janë shfaqur risqe të reja.

7. PËRFUNDIME

Raporti i monitorimit për vitin 2025 përbën pasqyrimin e nivelit të zbatimit të angazhimeve të përcaktuara në Planin e Integritetit 2024-2026 dhe shërben si bazë për ndjekjen e mëtejshme të masave dhe rekomandimeve për forcimin e integritetit institucional.

Përgatiti: Tatjana Muço